

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Lënda numër:

Pml. Kzz 216/2016

PAKR 266/2014 Gjykata e Apelit

P. Nr. 766/2012 Gjykata Themelore në Prishtinë

Datë:

12 maj 2017

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në një Trup Gjykues të përbërë nga Gjyqtarja Elka Filcheva-Ermenkova (Kryetare e Trupit Gjykues, Gjyqtarit Jorge Martins Ribeiro dhe Gjyqtari i Gjykatës Supreme Enver Peci, anëtarë të Trupit Gjykues dhe Zyrtari Ligjor i EULEX-it Kerry Moyes si procesmbajtës, në çështjen penale P. Nr. 766/2012 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ndaj të pandehurve:

- 1. AK;**
- 2. NK1;**
- 3. NK2;**
- 4. BL;**
- 5. FL;**
- 6. RM;**
- 7. NS;**
- 8. SS1;**
- 9. SS2;**
- 10. BS**

Të akuzuar sipas Aktakuzës PPS Nr. 07/2010 të datës 25 korrik 2011 dhe e konfirmuar me Aktvendimin e datës 26 gusht 2011, për kryerjen e një apo më shumë pikave të aktakuzës për veprat penale si në vijim:

Krime të Luftës ndaj Popullsisë Civile, sipas Nenit 22, 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (më tej “KPRSFJ”, tani e dënueshme sipas Nenit 31, 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (më tej “KPRK”), në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949 dhe Neneve 4, 5 (1) të Protokollit Shtesë II;

Krime Luftime ndaj të Burgosurve të Luftës, sipas Nenit 22, 142 të KPRSFJ, tani e dënueshme me Nenin 31, 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (më tej “KPRK”), në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949 dhe Neneve 4, 5 (1) të Protokollit Shtesë II;

Të gjykuar në shkallë të parë në Gjykatën Themelore në Prishtinë me Aktgjykimin P. Nr. 766/2012, të datës 17 shtator 2013;

duke vepruar sipas Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë KMLP.I.Nr. 12/2016 të parashtruar nga Zyra e Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës më datë 12 gusht 2016 ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 266/2014 të datës 26 Janar 2016 (këtë e tutje “Aktgjykimit të kundërshtuar”);

*pas shqyrtimit të Përgjigjeve të parashtruar nga: avokati mbrojtës Florim Vertopi dhe Xhafer Maliqi në emër të të pandehurit **NK1**, më 31 janar 2017; avokatit mbrojtës Bajram Tmava në emër të të pandehurit **NS** më 3 shkurt 2017; avokatit mbrojtës Mexhid Sylja në emër të të pandehurit **SS1** më 7 shkurt; avokatit mbrojtës Artan Qerkini në emër të të pandehurit **BS** më 8 shkurt 2017; avokates mbrojtëse Fehmiye Gashi-Bytyqi në emër të të pandehurit **AK** më 13 shkurt 2017; avokatëve mbrojtës Karim Khan dhe Tahir Rrecaj në emër të të pandehurit **FL**, më 13 shkurt 2017;*

pas këshillimit dhe votimit më 12 maj 2017;

në pajtim me Nenet 418 dhe Nenet 432-441 të Kodit të Procedurës Penale (më tutje “KPP”);

nxjerrë këtë

AKTGJYKIM

Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë KMLP.I Nr. 12/2016 e parashtruar nga Zyra e Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, më datë 12 gusht 2016 e parashtruar ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 266/2014, i datës 26 janar, refuzohet si e pabazuar.

ARSYETIM

1. Rrethanat përkatëse procedurale

Më 25 korrik 2011, Prokurori Special i EULEX-it ka ngritur Aktakuzën PPS Nr. 07/2010, duke i akuzuar të pandehurit **AK, NK1, NK2, BL, FL, RM, NS, SS1, SS2**, dhe **BS** (më tutje, së bashku, “të pandehurit”).

Më 21 Mars 2012, Gjykata Themelore ka nxjerrë një Aktvendim ku ka gjetur se dëshmia e dëshmitarit bashkëpunues **AZ** është e papranueshme.

Më 30 Mars 2012, Gjykata Themelore e ka veçuar procedurën dhe ka nxjerrë një Aktgjykim ku ajo i shpallë të pafajshëm të pandehurit **AK, BL, RM, SS1, SS2**, dhe **BS** për të gjitha veprat penale.

Më 2 maj 2012, Gjykata Themelore ka nxjerrë Aktgjykim ku të pandehurit **NK1, NK2, FL**, dhe **NS** i shpallë të pafajshëm për të gjitha veprat penale.

Më 20 nëntor 2012 dhe 11 Dhjetor 2012, Gjykata Supreme i ka anuluar që të dy Aktgjykimet dhe Aktvendimin i cili dëshminë e **AZ** e shpallë të papranueshme, dhe ka kthyer çështjet ndaj që të dhjetë të pandehurve në Gjykatën Themelore për rigjykim. Çështjet ishin bashkuar.

Më 17 Shtator 2013, Gjykata Themelore edhe një herë i ka shpallur të gjithë të pandehurit të pafajshëm për të gjitha akuzat. Prokurori i EULEX-it kishte parashtuar Ankesë ndaj këtij Aktgjykimi, e cila nëpërmjet Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të datës 26 janar 2016, ishte refuzuar si e pabazuar.

Më 12 gusht 2016, Prokurori i EULEX-it në Zyrën e Prokurorit të Shtetit (më tej, “Prokurori i Shtetit”) ka parashtuar një Kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të datës 26 janar 2016. Përgjigje ishin marrë nga avokati mbrojtës Florim Vertopi dhe Xhafer Maliqi në emër të të pandehurit **NK1**, më 31 janar 2017; avokatit mbrojtës Bajram Tmava në emër të të pandehurit **NS** më 3 shkurt 2017; avokatit mbrojtës Mexhid Sylja në emër të të pandehurit **SS1** më 7 shkurt; avokatit mbrojtës Artan Qerkini në emër të të pandehurit **BS** më 8 shkurt 2017; avokates mbrojtëse Fehmije Gashi-Bytyqi në emër të të pandehurit **AK** më 13 shkurt 2017; avokatëve mbrojtës Karim Khan dhe Tahir Rrecaj në emër të të pandehurit **FL**, më 13 shkurt 2017;

2. Parashtrësat e Palëve

2.1 Prokurori

Prokurori thekson se Aktgjykimi i kundërshtuar është në shkelje esenciale të ligjit të procedurës penale për shkak të zgjatjen të paligjshme të kohës për parashtrim të përgjigjes, dhe se ekzistojnë dyshime të konsiderueshme për sa i përket saktësisë së vërtetimit faktik, siç parasheh Neni 439 i KPP.

a. Zgjatja e paligjshme e kohës për parashtrim të përgjigjes

Prokurori i Shtetit thekson se Gjykata e Apelit në mënyrë të gabuar ka pranuar si të paraqitura me kohë disa përgjigje të mbrojtësve ndaj Ankesës së Prokurorit Special, kështu që në mënyrë esenciale ka shkelur Nenet 432 (2), 384 (2.1) dhe 455 (1) të KPP. Ankesa e Prokurorit Special ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore ishte parashtruar më datë 29 Nëntor 2013. Gjykata e Apelit ka theksuar afatin prej tetë ditësh për të parashtruar ankesë, ashtu siç parashihet në KPP, por ka theksuar se ajo ka marrë parasysh udhëzimet shtesë të Gjykatës Themelore që i janë dhënë avokatit mbrojtës nëpërmjet email-it të datës 12 Dhjetor 2013, sipas të cilit mbrojtja mund të parashtrrojë një përgjigje deri më “në fund të orarit të punës” të datës 31 Dhjetor 2013. Prokurori i Shtetit parashtron që Gjykata e Apelit ka gabuar në pranimin e procedurës së parregullt të zgjatjes së afatit për parashtrimin e përgjigjeve në ankesë. Neni 445(1) i KPP është i qartë, duke theksuar se afati i paraparë i parashikuar nga Kodi i tanishëm nuk mund të zgjatet përveç nëse ligji në mënyrë të qartë e lejon atë. Gjykata e Apelit nuk e ka siguruar asnjë bazë ligjore për lejimin e vazhdimin të afatit të përcaktuar më Nenin 388 (2) të KPP, dhe është thirr vetëm në faktin se një vazhdim i tillë është në të mirën e të pandehurve. Kjo gjithashtu e shkel parimin themelor të barazisë së palëve e paraparë në nenin 9 (1) të KPP. Më tutje, Prokurori i Shtetit thekson se nëse Gjykata e Apelit e ka lejuar këtë duke zbatuar parimin e *in dubio pro reo*, ky parim nuk zbatohet në ligjin e procedurës dhe citon se Aktvendimi i Gjykatës Supreme Pml. Kzz nr. 18/2013, i datës 24 prill 2013, i cili thekson se “*Parimi in dubio pro reo dhe prezumimi i pafajësisë nuk zbatohen në të drejtën materiale penale, ashtu siç reflektohet në formulimin e dispozitës ligjore*”.

b. Neni 439 i KPP – dyshimi i konsiderueshëm lidhur me saktësinë e fakteve vendimtare

Prokurori i Shtetit vë në dukje se rregulla e përgjithshme në Nenin 432 (2) dhe 437 të KPP se Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë nuk mund të parashtrohet mbi bazën e një vërtetimi të gabuar dhe jo të plotë të situatës faktike. Ajo gjithashtu thekson se Neni 438 (2) i KPP, i cili thotë se nëse Gjykata Supreme e Kosovës gjen se një Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë është parashtruar në dëm të të pandehurit, është e bazuar mirë, ajo mundet vetëm të vërtetoj se është shkelur ligji por nuk duhet të ndërhyjë në vendimin e formës së prerë. Megjithatë, Prokurori i Shtetit pretendon se kjo rregullë e përgjithshme nuk është e karakterit absolut, dhe ekziston një përjashtim në Nenin 439 të KPP. Ky nen parasheh se nëse paraqitet dyshimi i konsiderueshëm për saktësinë e fakteve vendimtare në një vendim të kundërshtuar me një Kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë, Gjykata Supreme duhet ta anulojë atë vendim dhe urdhëron mbajtjen e shqyrtimit të ri gjyqësor në gjykatën e njëjtë ose në gjykatën tjetër themelore. Prokurori i Shtetit pretendon se ky nen zbatohet madje edhe kur Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë është parashtruar në dëm të pandehurit. Në mbështetje të vlerësimit të saj, ajo e citon Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Pml. Kzz. Nr. 170/2014, të datës 19 shkurt 2015, i cili në paragrafin 83 thekson se: “*I pandehuri ka paraqitur disa argumente të cilat nuk mund të cilësohen si shkelje të ligjit të procedurës penale...Këto argumente janë hudhur si pretendime të papranueshme të një vërtetimi të gabuar dhe jo të plotë të situatës*

faktike sipas Nenit 432 paragrafi 2 i KPP. Neni 439 i KPP nuk zbatohet këtu sepse nuk mund të gjendet një “dyshim i konsiderueshëm për vërtetimin faktik të vendimit të kundërshtuar”.

Prokurori i Shtetit thekson se kjo gjetje tregon se Gjykata Supreme a ka përfshirë veten në analizë të situatës faktike, dhe ka konstatuar se nuk mund të gjendet dyshimi i konsiderueshëm për vërtetimin faktik. Prokurori i Shtetit konstaton se Neni 439 i KPP e mbizotëron ndalimin e përgjithshëm të shqetësimit të një vendimi të formës së prerë, në dëm të pandehurit. Roli i Gjykatës Supreme në rrethana të zakonshme duhet të jetë i kufizuar në dëgjimin e kundërshtimeve ndaj çështjeve të ligjit, megjithatë, ligjvënësi ka bërë një përjashtim nga kjo rregullë e përgjithshme, dhe në këtë rast, dëshmitë duhet të analizohet edhe një herë nga një tjetër Trup Gjykues.

Prokurori i Shtetit jep detaje se cilët, sipas pikëpamjes së saj, janë gabimet e rënda në Aktgjykimin e kundërshtuar. Këto, në tërësi, demonstrojnë dyshimin e konsiderueshëm lidhur me saktësinë e fakteve vendimtare. Në veçanti, Prokurorja e Shtetit vëren se Gjykata e Apelit ka gjetur se qëndrueshmëria dhe besueshmëria e dëshmitarit bashkëpunues **AZ** është vendimtare për rezultatin e çështjes për shkak të faktit se Aktakuza dhe Aktgjykimi janë bazuar kryesisht në dëshmitë e tij. Gjykata e Apelit gjithashtu ka vërtetuar gjetjet e Trupit Gjykues se dëshmitë e **AZ** ishin të paqëndrueshme, të pabesueshme dhe jo kredibile. Prokurorja e Shtetit pretendon se Gjykata e Apelit ka abuzuar rëndë me diskrecionin e saj në vlerësimin e besueshmërisë të **AZ** dhe se kjo është e një proporcioni aq alarmues që ato së bashku të konsiderohen si dyshime të konsiderueshme në lidhje me saktësinë e vërtetimit faktik, sipas nenit 439 të KPP.

2.2 Avokatët mbrojtës

- a. Përgjigja e parashtruar nga Florim Vertopi dhe Xhafer Maliqi në emër të pandehurit **NK1**. Mbrojtësit kanë deklaruar se PSRK nuk e ka specifikuar se kur ajo e ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, dhe prandaj nuk mund të dihet se a është parashtruar më kohë Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë. Mbrojtësit theksojnë se Neni 439 i KPP nuk është i zbatueshëm. Kjo është për shkak se, në pajtim me Nenin 438 (2), Gjykata Supreme duhet ta kufizojë veten vetëm në vërtetimin e ekzistimit të shkeljes së ligjit por nuk duhet të ndërhyjë në vendimin e formës së prerë. Prandaj, kërkesa e PRSK-së proceduralisht është e papranueshme dhe e pabazuar. Lidhur me nenin 439 të KPP, avokatët mbrojtës përsërisin kjo nuk lidhet me Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, dhe është e rëndësishme vetëm për ankesat ndaj Aktgjykimeve. Avokatët mbrojtës i propozojnë Gjykatës Supreme që Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.
- b. Përgjigja e parashtruar nga Bajram Tmava në emër të pandehurit **NS**. Mbrojtësi thekson se nuk është në kuadër të kompetencës së Prokurorit të PSRK-së që të vlerësojë nëse përgjigjet e mbrojtjes ndaj ankesës së PSRK-së janë parashtruar brenda afatit. Avokati

- mbrojtës interpreton Nenin 388 (2), i cili thotë se pala kundërshtare “... mund të parashtrijë përgjigje në ankesë brenda tetë (8) ditëve nga dorëzimi” që do të thotë se afati kohor nuk është i domosdoshëm. Mbrojtësi gjithashtu thekson që Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë nuk mund të paraqitet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, në pajtim me nenin 432 (2) të KPP. Më tej, neni 438 (2) i KPP është i qartë në atë se vendimi i Gjykatës Supreme mbi Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë nuk mund të jetë në dëm të të pandehurit. Përndryshe, Kërkesa e paraqitur nga Prokurorja bazohet në vlerësimin e Prokurores për besueshmërinë e provave, me të cilin nuk pajtohet mbrojtësi. Ai propozon që Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, Gjykata Supreme ta hedh poshtë si të papranueshme.
- c. Përgjigja e parashtruar nga Mexhid Syla në emër të pandehurit **SS1**. Mbrojtësi ka theksuar se Kërkesa e PSRK-së është e pakuptueshme, e paqartë dhe kundërtënëse, dhe është e paqartë se cili aktgjykim është kundërshtuar. Përndryshe, neni 432 i KPP e përcakton qartë arsyen se kur mund të parashtrohet Kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë. Kjo nuk e përfshinë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe neni 439 i KPP nuk e lejon këtë mundësi, Më tej, Kërkesa nuk e përmend **SS1**, dhe prandaj mbrojtësi konstaton se Kërkesa nuk ka fare të bëjë me të. Mbrojtja propozon që Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, Gjykata Supreme ta refuzojë si të pabazuar dhe të vërtetoj Aktgjykimin që është objekt i kësaj Kërkese.
- d. Përgjigja e parashtruar nga Artan Qerkini në emër të pandehurit **BS**. Mbrojtësi thekson se Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë nuk është e bazuar në KPP. Prokurorja synon të interpretoj ligjin në mënyrë selektive dhe në kundërshtim me natyrën e ligjit dhe qëllimin e ligjvënësit. Prokurorja është përpjekur të japë nenit 439 të KPP kuptim të shtrembëruar duke u mbështetur në nenin 4 (2) të KPP-së, i cili shton “... përveç kur parashikohet ndryshe me këtë Kod” për të thënë se kjo mund të përdoret për të zbatuar nenin 439 të KPP. Neni 4 nuk mund të përdoret për t’i dhënë kuptim nenit 439 sepse këto nene nuk i përkasin Kapitujve të njëjtë të KPP, dhe neni 439 është në kapitullin XXI i cili ka të bëjë me mjetet juridike të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Më tej, neni 438 (2) i KPP thotë që “Kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë”. Kjo dispozitë është shumë e qartë dhe ligjvënësi ka dashur të mos lërë hapësirë për të ndryshuar vendimin e formës së prerë në dëm të pandehurit në këto rrethana. Çdo interpretim tjetër i këtyre dispozitave do të ishte gjithashtu në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike. Avokati mbrojtës citon Profesor Rexhep Muratin i cili në komentimin e KPP, thotë se sipas nenit 438 (2) pavarësisht nga pesha dhe natyra e shkeljes, aktgjykimi i formës së prerë nuk mund të kthehet në dëm të të pandehurit. Më tutje, nëse ligjvënësi do të kishte dashur që neni 439 i KPP të përdorej gjithashtu kur një Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë është parashtruar kundër të pandehurit, ai do ta kishte thënë këtë në mënyrë të qartë. Prokurorja është duke u përpjekur ta kthejë Gjykatën Supreme në një gjykatë të fakteve, pavarësisht nga misioni i saj ligjor që të merret ekskluzivisht me çështje ligjore të natyrës materiale dhe procedurale. Qëndrimi i PSRK-së se dy gjykatat e shkallëve të ndryshme të

gjkimit kanë bërë shkelje faktike në atë masë sa që ekziston dyshim i konsiderueshëm në lidhje me saktësinë e fakteve kryesore nuk mund të pranohet. Mbrojtësi i propozon Gjykatës Supreme që Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë ta hudhë poshtë si të papranueshme ose ta refuzojë atë si të pabazuar.

- e. Përgjigja e paraqitur nga Fehmije Gashi-Bytyqi në emër të pandehurit **AK**. Gjykata e shkallës së parë e ka shpallur Arben Krasniqi të pafajshëm kurse pafajësia e tij u vërtetua edhe me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit. Prandaj, avokati mbrojtës propozon që Gjykata Supreme ta hedh poshtë Kërkesën e Prokurorit për Mbrojtjen e Ligjshmërisë si të pabazuar.
- f. Përgjigja e paraqitur nga Karim Khan dhe Tahir Rrecaj në emër të pandehurit **FL**. Avokatët mbrojtës theksojnë se Kërkesa e Prokurorisë është paraqitur sipas Kodit të gabuar të Procedurës Penale dhe është e pavlefshme nga aspekti procedural. Ligji i aplikueshëm është Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale dhe jo Kodi i Procedurës Penale që ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013. Kjo sepse aktakuza në këtë rast është ngritur më 25 korrik 2011. Avokatët mbrojtës theksojnë se ndjekja e **FL** nga Prokurori i EULEX-it me çdo kusht dhe mos përmbajtje gjykimi është pjesë e kontekstit të këtij rasti dhe po ashtu u jep ngjyrë parashtresave thelbësore në Kërkesë. Pretendimi i prokurorisë në lidhje me ‘zgjatjen e afatit’ që i është dhënë mbrojtjes për ta paraqitur përgjigjen e vet në Gjykatën e Apelit është një përpjekje për të krijuar baza për ankesa pavarësisht meritave dhe pa i përfillur dispozitat e qarta të ligjit. Në atë kohë prokurori nuk e ka kundërshtuar vazhdimin që ishte aprovuar më 12 dhjetor 2013 apo në dëgjimin e Gjykatës së Apelit, apo ndonjëherë deri në gusht 2016. Përpos kësaj, Prokurori mund ta paraqes një Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë përkitazi me shkeljen ligjore dhe nuk i lejohet të ngre ankesa që kanë të bëjnë me vërtetimin faktik të Gjykatës së Apelit, sipas Nenit 432 (3) të KPP. Prokuroria thjesht nuk pajtohet me vërtetimin faktik të gjykatës së shkallës së dytë dhe kjo nuk bëhet sipas kushteve të Neneve 432, 438 dhe 439 të KPP. Avokatët mbrojtës i ofrojnë disa detaje se pse, në çdo rast, vërtetimi i gjendjes faktike nga Gjykata e Apelit nuk ka qenë i gabuar. Avokatët mbrojtës kërkojnë që Gjykata Supreme të hedh poshtë Kërkesën si e parregullt proceduralisht dhe/ose ta refuzojë kërkesën si të pabazuar. Avokatët mbrojtës po ashtu kërkojnë që Gjykata Supreme ta sanksionojë Prokurorin për shkeljen e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Prokurorëve.

3. Konstatimet e Trupit Gjykues

3.1 Pranueshmëria

Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, datë 26 janar 2016 i është dërguar Prokurorit të Shtetit më 13 maj 2016. Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë është paraqitur nga shërbimi i prokurorisë më 12 gusht 2016, kështu që është e paraqitur me kohë.

Gjykata Supreme vëren se në pajtim me Nenin 432 paragrafin 3, Kryeprokurori i Shtetit mund të paraqes një kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë mbi bazën e çfarë do shkeljeje të ligjit. Gjykata Supreme e pranon bazën e parë [432(3)KPP] të Kërkesës së Prokurorisë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë e që ka të bëjë me kohën e lejueshme me Nenin 388 paragrafin 2 për paraqitjen e një

përgjigjeje në ankesë, si e mjaftueshme në substancë për ti përmbushur kërkesat e Nenit 432 paragrafit 3. Kështu që, Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë është e pranueshme mbi këtë bazë.

Baza e dytë e Kërkesës së Prokurorit për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, që ka të bëjë me Nenin 439 me titullin ‘Pasojat e Dyshimit Faktik në Vendimin e Kundërshtuar me Kërkesë’, nuk është një bazë e pavarur për paraqitjen e një Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë. Trupi gjykues konsideron se një gjë e tillë është e dukshme nga përpilimi i Nenit 439 i cili thekon, “*Nëse në procedurë të një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ngritën dyshime të konsiderueshme përkitazi me vërtetimin faktik në një vendim të kundërshtuar me kërkesë... Zbatimi i Nenit 439 është një çështje ku Gjykata Supreme e Kosovës ta zbatojë ex-officio nëse ka nevojë derisa është duke e shqyrtuar Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë dhe në rast se lindin dyshime të konsiderueshme lidhur me saktësinë e gjendjes faktike. Kjo e drejtë e posaçme e Gjykatës Supreme është e zbatueshme nën kushte të caktuara mbi të cilat gjykata do të elaborojë më gjerë në pjesën e meritave të kërkesës.*

Një Përgjigje është paraqitur nga Florin Vertopi dhe Xhafer Maliqi në emër të pandehurit **NK1** më 31 janar 2017. Një Përgjigje është paraqitur nga Bajram Tmava në emër të pandehurit **NS** më 3 shkurt 2017. Një Përgjigje është paraqitur nga Artan Qerkini në emër të **BS** më 8 shkurt 2017. Një Përgjigje është paraqitur nga Fehmije Gashi-Bytyqi në emër të pandehurit **AK** më 13 shkurt 2017. Një Përgjigje është paraqitur nga Karim Khan dhe Tahir Rrecaj në emër të pandehurit **FL** më 13 shkurt 2017.

Kështu që, përgjigjet janë të pranueshme dhe të paraqitura me kohë.

3.2 Meritat e Kërkesës për Mbrojtjen e Ligjshmërisë

a. Vazhdimi i paligjshëm i afatit për paraqitjen e përgjigjes

Prokuroria thekson se Gjykata e Apelit, gabimisht dhe në kundërshtim me Nenin 388 (2) të KPP ka pranuar disa nga përgjigjet e mbrojtjes ndaj ankesës së Prokurorit si të paraqitura me kohë, duke marrë si arsye udhëzimet e Gjykatës Themelore për avokatët mbrojtës përmes emailit duke u lejuar atyre afat deri në fund të ditës të datës 31 dhjetor 2013. Të gjitha përgjigjet janë paraqitur para këtij afati. Prokuroria thekson se ekziston një shkelje thelbësore e procedurës penale, sipas Nenit 384 paragrafit 2, pikës 2.1. Gjykata Supreme pajtohet që paragrafi 2 i Nenit 388 i titulluar “Procedura e Paraqitjes së Ankesave ndaj Aktgjykimeve” është i qartë kur thotë se përgjigja në ankesë mund të paraqitet brenda tetë (8) ditëve nga dita e pranimit. Neni 445, i titulluar “Afatet e kohore” thekson në paragrafin 1 që “Periudhat e përcaktuara kohore të parapara me Kodin aktual nuk mund të vazhdohen përpos nëse lejohen shprehimisht me ligj”, dhe kjo është po aq e qartë.

Sidoqoftë, Trupi gjykues është i mendimit se elementi thelbësor i kësaj çështjeje është se paraqitja e përgjigjeve nga avokatët mbrojtës pas afatit të paraparë me KPP nuk ishte për faj të avokatëve mbrojtës. Këta të fundit kanë vepruar kësi soji në mbështetje të udhëzimit nga gjykata dhe brenda afatit kohor të atij udhëzimi. Prandaj, si rezultat ata nuk duhen penguar pavarësisht nëse udhëzimi ka qenë në pajtim me ligjin e procedurës apo jo. Trupi gjykues nuk pajtohet se kjo pozitë shkel parimet e barazisë së palëve apo është në ndjekje të parimit *in dubio pro reo*. Trupi gjykues i Gjykatës Supreme do ta kishte sjellë të njëjtin përfundim po të kishte qenë Prokurori ai i cili e kishte paraqitur

një përgjigje më vonë se koha e lejuar me KPP në mbështetje të udhëzimit gjyqësor. Do të ishte krejtësisht e padrejtë dhe në kundërshtim me parimet e gjykimit të drejtë nëse penalizohet ndonjëra palë për shkak të zbatimit të gabueshëm të ligjit të procedurës nga ana e gjykatës.

Trupi gjykues gjithashtu është i ndërgjegjshëm përkitazi me kërkesën e paraparë me Nenin 432 paragrafi 1 pik 1.3 të KPP, i cili thekson se një Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë mund të ushtrohet mbi bazën e një shkeljeje tjetër të dispozitave të procedurës penale nëse një shkelje e atillë ka ndikuar në ligjshmërinë e një vendimi gjyqësor. Trupi gjykues është i mendimit se kjo kërkesë po ashtu zbaton Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë ta paraqitur nga Prokuroria përmes Nenit 432 (2), sikurse në këtë rast. Trupi gjykues është i mendimit se ky gabim procedural nuk ka ndikuar në nxjerrjen e një vendimi të ligjshëm dhe të drejtë. Zgjatja e afatit kohor për paraqitjen e një përgjigjeje është një çështje që ka lindur në procedurat e apelit të këtij rasti dhe i cila rrjedhimisht ke lindur pas vendimit të Gjykatës së Apelit. Prokuroria nuk ka siguruar një shembull konkret se si zgjatja e afatit i ka lejuar avokatëve mbrojtës nxjerrjen e një vendimi të ligjshëm nga Gjykata e Apelit. Nuk mund të paragjykohet se avokatët mbrojtës nuk do ti paraqitnin me kohë përgjigjet nëse afati i lejuar me Nenin 388 të KPP nuk do të ishte zgjatur nga gjykata, e as nuk mund të paragjykohet se Gjykata e Apelit do të mund të sillte një vendim tjetër nëse ajo do ti konsideronte si të vonuara përgjigjet e paraqitura nga avokatët mbrojtës.

Trupi gjykues konsideron se nuk ka arsye për të konstatuar se zgjatja e afatit kohor i lejuar nga Gjykata për avokatët mbrojtës për të paraqitur një përgjigje ka pasur ndikim në nxjerrjen e një vendimi ligjor nga ana e Gjykatës së Apelit, apo të jemi më të saktë, në meritat e vendimit. Prandaj, Trupi gjykues refuzon Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë si të pabazuar.

b. Neni 439 i KPP

Siç është theksuar më lart, Trupi gjykues është i mendimit se Neni 439 i KPP-së në vetvete nuk është një bazë për paraqitjen e një Kërkese për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, por në fakt, është një çështje që Trupi gjykues i Gjykatës Supreme ta zbatojë ex-officio derisa është duke shqyrtuar një Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë dhe në rast se lind dyshimi i konsideruar për sa i takon vërtetësisë së gjendjes faktike.

Trupi gjykues ka gjetur se Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë e paraqitur nga Prokuroria është e pranueshme mbi bazën e Nenit 432 (3), dhe kështu Trupi gjykues do ti shqyrtojë parashtrirat e bëra në lidhje me zbatueshmërinë e Nenit 439. Prokuroria thekson se Neni 439 përbën një përjashtim në Nenin 438 (2), i cili thekson se nëse Gjykata Supreme e Kosovës gjen se një Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë e paraqitur në dëm të pandehurit është e bazuar mirë, ajo duhet të vërtetojë se ka pasur shkelje ligjore pa ndikuar në vendimin përfundimtar. Prokuroria thekson se Neni 439 zbatohet edhe ku Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë parashtrohet në dëm të të pandehurit.

Neni 439 thekson se:

Kur me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ka dyshim të konsiderueshëm lidhur me saktësinë e fakteve vendimtare të vërtetuara në vendimin kundër të cilit është paraqitur kërkesë, Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykim me të cilin vendos mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë anulon vendimin dhe urdhëron mbajtjen

e shqyrtimit të ri gjyqësor në gjykatën e njëjtë ose në gjykatën tjetër themelore.

Prokuroria kërkon nga Gjykata Supreme të konstatojë se ka pasur dyshime të konsiderueshme përkitazi me vërtetësinë e gjendjes faktike në aktgjykimin e kundërshtuar, dhe ta anulojë si aktgjykimin e kundërshtuar e Gjykatës Themelore dhe ta kthejë rastin në Gjykatën Themelore për rigjykim para një Trupi gjykues tjetër.

Trupi gjykues është i mendimit se, në zbatim të Nenit 439, Gjykata Supreme mund ta anulojë një aktgjykim dhe ta kthejë rastin në rigjykim vetëm nëse ekziston një mundësi e një aktgjykimi më të favorshëm për të pandehurin, me rastin e një procedure të re. Neni 439 duhet të lexohet me Nenin 440, i cili parasheh në paragrafin 4 se, kur një aktgjykim i formës së prerë anulohet dhe rasti dhe rasti kthehet për rigjykim, ‘me rastin e nxjerrjes së një vendimi të ri, gjykata është e obliguar me ndalesat e Nenit 395 të këtij Kodi.’ Neni 395 i KPP siguron një kufizim Reformation in Peius dhe, derisa ky Nen është i zbatueshëm vetëm për klasifikimin ligjor të veprës dhe sanksionit penal të caktuar, Neni 438 (2) është më i gjerë dhe i referohet ‘dëmit ndaj të pandehurit’.

Në këtë rast, në një rigjykim të të pandehurve nuk ekziston mundësia e një aktgjykimi më të favorshëm për të pandehurit, pasi që të gjithë ata janë shpallur të pafajshëm për të gjitha veprat penale. Për këtë arsye, edhe nëse në mënyrë hipotetike do të ishin paraqitur dyshime të konsiderueshme në kuptim të Nenit 439, nuk do të kishte asnjë qëllim anulimi i aktgjykimit të kundërshtuar dhe kthimi i rastit në Gjykatën Themelore për rigjykim.

Përpos kësaj, nëse Neni 439 do të aplikohet në dëm të të akuzuarit/pandehurit, kjo do ta bënte Nenin 438 (2) të vjetruar. Në bazë të asaj dispozite, vendimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë paraqitur në dëm të të akuzuarit nuk ndikon në një aktgjykim efektiv, por mund të ketë vetëm efekt deklarativ të shpalljes se ligji ishte shkelur.

Prokurori i referohet Nenit 4 të KPP me titull ‘*Ne Bis in Idem*’ dhe në mënyrë specifike paragrafit 2 të Nenit 4 i cili thekson se ‘*një vendim përfundimtar i gjykatës mund të anulohet përmes një mjeti të jashtëzakonshëm juridik vetëm në favor të palës së dënuar, përpos nëse ndryshe përcaktohet me kodin aktual*’. Trupi gjykues nuk pajtohet me Prokurorinë se një përjashtim i Nenit 4 (2) sigurohet me Nenin 439 në dëm të të pandehurit, pasi që Neni 438 (2) atëherë nuk do të kishte kuptim, siç është përcaktuar më lart. Me Nenin 439 do të ishte e mundur vetëm e kundërta – nëse dyshimet do të shkaktonin një rigjykim i cili mund të qonte në një vendim më të favorshëm. Përjashtimet sipas Nenit 4 (2) në dëm të të pandehurit mund të gjenden vetëm në Nenin 423 (2) në lidhje me Nenin 423 (1.) dhe 423 (1.2) lidhur me rihapjen e procedurës penale. Aty, ligji shprehimisht thekson se procedura penale e përfunduar me një aktgjykim të formës së prerë mund të rihapen në dëm të të pandehurit nëse dëshmohet se rrethanat nga Nenin 423 (1.1) dhe 423 (1.2) kanë qenë si rezultat i një vepre penale të kryer nga i pandehuri ose një person që ka vepruar në emrin e tij/saj kundër një dëshmitari, dëshmitari të specializuar, përkthyesi, prokurori të shtetit, gjyqtari apo personave të afërt më ata persona. Këto janë të vetmet përjashtime që mund të përfshihen me Nenin 4 (2)

Si *obiter dictum*, Gjykata konsideron të dobishme të përsëris parimin in dubio pro reo dhe obligimin e gjykatave për ta interpretuar dyshimet në lidhje me ekzistimin e fakteve përkatëse të rastit në favor të pandehurit. Kjo përmendet sepse prokuroria përsërit disa herë se ekzistojnë dyshime mbi

vërtetimin e drejtë të fakteve por nëse është kështu, të gjitha dyshimet duhet të interpretohen në favor, e jo në dëm të pandehurve.

Neni 438(2) qartazi ia ndalon Gjykatës Supreme ndërhyrjen në një vendim përfundimtar ku paraqitet Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë në disfavor të pandehurit dhe kur konstatohet se është e bazuar mirë. Kjo qartazi pasqyron qëllimin e ligjvënësit për të qenë i qëndrueshëm gjë që mund të konstatohet edhe nga leximi sistematik i Neneve 4, 432, 438 dhe 439 të KPP.

Gjykata vëren gjithashtu se instituti i Nenit 439 nuk është i ri për traditën ligjore në Kosovë. Një dispozitë e tillë ka ekzistuar në Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës të vitit 2003, ku ishte pasqyruar në Nenin 458. Para kësaj, kur Kosova ka qenë pjesë e ish Jugosllavisë çështja ishte rregulluar në nivelin federativ me Nenin 423 të Kodit të Procedurës Penale të Jugosllavisë. Jurisprudenca e Gjykatës Supreme të atëhershme ka qenë na harmoni me kuptimin (të cilin Trupi gjykues aktual e ndan në tërësi me leximin sistematik të procedurës penale siç u përmend më lart) se nuk ka kuptim “anulimi i një aktgjykimi dhe dërgimi i rastit për rigjykim” nëse nuk ka mundësi për një vendim më të favorshëm (shih vendimin e Gjykatës Supreme të Jugosllavisë Kz. 17/70 të 17 nëntorit 1970, të cilit i referohen komentaret e neneve të Ligjit të Jugosllavisë mbi Procedurën Penale – faqe 231 i përkthimit anglisht). Dhe në rastet sikurse ky në fjalë, aktgjykimi më i favorshëm tashmë është nxjerrë.

Si rrjedhojë, për këtë gjykatë është e panevojshme të shqyrtohen argumentet në lidhje me vërtetësinë e vërtetimit të fakteve mbi meritat. Për arsyet e shpjeguara më lart, Trupi gjykues gjen se nuk do të shërbente asnjë qëllimi legjitim futja në diskutim dhe vlerësim të fakteve të rastit, apo të përmbajtjes së aktgjykimit të kundërshtuar.

Për arsyet e përmendura ma lart, është vendosur si në dispozitiv.

Kryetari i trupit gjykues

Elka Filcheva-Ermenkova

Gjyqtare e EULEX-it

Procesmbajtëse

Kerry Moyes

Zyrtar ligjor i EULEX-it

Anëtarët e trupit gjykues

Jorge Martins Ribeiro

Enver Peci

Gjyqtar i EULEX-it

Gjyqtar i Gjykatës Supreme